

FJALA E DEPUTETIT FATIION VEIZAJ

E HËNË 6 QERSHOR 2022

Të nderuar kolegë,

Sado që përpiqemi t'i japim punës sonë një kuptim normal, në këtë vend është e pamundur të mbash një rend logjik të pritshëm dhe të natyrshëm. Nuk e ekzagjeroj kur them se çdo ditë e kësaj qeverisjeje është plot akte, që sfidojnë arsyen, jetën dhe sigurinë e cilitdo qytetari në Republikën e Shqipërisë. U bë kohë që Shqipëria duhet t'i shkojë pas një individi, të mos kërkojë shpjegime, të mos bëj pyetje dhe të pranojë me kokën ulur pasojat e projekteve të tij, që shiten si modernitet, si vizion, por që praktika, në pjesën dërrmuese të tyre, i provon si deformime të historisë ose si kotësi të mbivlerësuar nëpërmjet propagandës. Po jap tri shembuj: në fillim u bë eksperimenti me e-Albania-n.

Nga data 1 maj pjesa dërrmuese e shërbimeve që jepeshin në sportele u kaluan tek e-Albania. Pavarësisht mundësive të pjesës më të madhe të qytetarëve për ta përdorur këtë shërbim, por edhe kolaudimit të pamjaftueshëm dhe problemeve të përsëritura të sistemit, kjo platformë tregoi se nuk e përballon dot regjistrin e madh të detyrimeve që i kërkohen. Për shembull, aplikimi për ç'regjistrim nuk ekziston në portal, por ndërkohë krijon detyrime të tepërta dhe pa zgjidhje për të interesuarit. Problem tjetër është regjistrimi i ndryshimit të afatit të administratorit, që shpesh nuk është i mundur edhe kur aplikuesi është vetë administratori, jo më kur administratori është i huaj, pasi programi nuk ka asnjë opsion për këtë rast apo kur prej tij kërkohet depozitimi në sistem i pasqyrave financiare.

Problematikë mbetet ripërtëritja e certifikatës së fiskalizimit. Sistemi nuk arrin t'i gjenerojë automatikisht njoftimet përkatëse, por subjektet ndëshkohen edhe kur shkak është vetë e-Albania. Komunikimi nëpërmjet postës elektronike për çështjet e përmendura në shumicën e rasteve është tërësisht jashtë shërbimit, edhe pse kjo duhet të ishte një përparësi absolute në marrëdhëniet me bizneset. Përmenda shkurt 2-3 shqetësime nga hapësira e problematikave,

por ajo është shumë më e madhe dhe më e ndërlikuar. Mund të prisnit edhe disa kohë për një sistem më të qëndrueshëm, më efikas, pa i hyrë një aventure me çmim më të lartë sesa bakshishet që do të paguheshin nëpër sportele.

Software-t janë për të shërbyer, jo për t'u shërbyer ne atyre. Për sa i përket rritjes së çmimeve, sidomos atij të karburantit, dihet se kjo ka qenë një prirje globale, por, ndërsa kostot për qytetarët shqiptarë kanë shkuar aty ku s'mbajnë më, përkundrazi, qeveria shqiptare është përfituesja më e madhe. Sipas të dhënave zyrtare, efekti i rritjes së çmimeve në këtë katërmujor, e krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, është rreth 300 milionë euro të arkëtuara në buxhet. Sipas Ministrisë së Financave, niveli i suficitit në këtë periudhë katërmujore rezulton të jetë 19,2 miliardë lekë, ndërkohë që në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar deficiti ishte 14,8 miliardë lekë. Arsyeja dihet: qeveria nuk ndërhyri në masën e barrës fiskale dhe përfundimi është paradoksal.

Jeni bërë bajat duke u krahasuar me rajonin, por më në fund, për herë të parë, çmimi i karburantit në Shqipëri ia kaloi edhe atij në Itali. Një litër naftë në Itali sot kushton 1,8 euro ose afërsisht 216 lekë, kurse në Shqipëri kushton 2,1 euro ose 248 lekë. Ndërkohë, duhet pasur parasysh edhe diferenca në të ardhura në pagë minimale dhe mesatare të qytetarëve tanë dhe atyre italianë. Edhe pse teorikisht një shoqëri transporti apo biznes të ndryshëm ka interes ta blejë naftën jashtë, kjo i penalizon, sepse nuk u njihen shpenzimet. Besoj se nuk është vendi t'ju kujtoj shakatë e hidhura të Kryeministrit për krahasimet me çmimet e larta të vitit 2013 dhe propagandën që fsheh një mungesë të madhe përgjegjësie karshi qytetarëve.

Një fushë tjetër ku qeveria ka ekspertizë arbitraritetin, për të mos thënë dhunën, janë gjobat e vendosura nga Policia Rrugore. Pa dyshim, zbatimi i rregullave të qarkullimit është detyrim i pashmangshëm ligjor, por kjo vlen edhe për policinë, në kuptimin e respektimit të të drejtave dhe lirive kushtetuese të individit. U bë kohë që njoftohen raste kur qytetarët nuk janë vënë në dijeni për shkeljen dhe gjobat e marra, por ndërkohë vijohet të merren masa të rënda pa asnjë kontakt me të interesuarit.

Më pas, qytetarët ndalohen në rrugë dhe u bllokohet mjeti për të paguar një gjobë për të cilën nuk janë në dijeni. Gjopa në vetvete është një akt administrativ dhe i jep të drejtën qytetarit ta

ankimojë, ndaj kërkohet nga policia të paktën të ketë dinjitet që ta njoftojë dhe të mos shkruajë në sistemet e veta se nuk u gjet njeri në shtëpi. Duket sikur ndëshkimi është qëllim në vetvete dhe në të vërtetë ashtu është, ndaj duhet kuptuar që policimi në këto çështje është shërbim, duhet kryer rigorozisht, pa lëshim, por me korrektesë.

Të nderuar kolegë,

Thelbi i këtyre fjalëve është diçka midis anarkisë dhe etatizmit. Të dyja bashkë bëhen për të shtypur shoqërinë e duke ndërtuar një cikël anormal qeverisjeje. Nuk ka çfarë të mirë të presim nga e gjithë kjo, për shumë arsye, por duke u shtuar edhe pamjaftueshmërinë e një opozite në shërbim të zgjedhësve të saj, këtu është ulur këmbëkryq autoritarizmi. Faleminderit!